



DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT THIRRJE PUBLIKE

Duke u bazuar në “Rregullore MF – NR – 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve” Komuna e Klinës – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport shpall:

Thirrje publike – për mbështetje financiare për vitin 2026, për OJQ - Shoqatat e Dalura nga Lufta që veprojnë në komunën e Klinës, programi i të cilave është i fokusuar në fushëveprimtarinë e shënimit të datave historike, përvjetorëve, homazhe, akademi përkujtimore etj.

Data e hapjes së thirrjes 10.03.2026

Afati i fundit për aplikim 30.03.2026

- Shoqatat në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte/programe të tyre në organizime përkatëse:
 - Organizimi i datave me rëndësi historike, përvjetorë, akademi përkujtimore, homazhe etj.
 - Organizimi i aktiviteteve sipas fushëveprimtarisë që organizatat e kanë në statusin e regjistrimit në ministrinë përkatëse.
- **Mënyra si të aplikoni, dokumentet e nevojshme:**
 - Formulari i aplikimit - Formulari i projektit (aktiviteteve)- Formulari 9
 - Formulari i buxhetit- Formulari 10
 - Deklaratë mbi financimin e dyfishtë – Formulari 11
 - Dokumenti identifikues (kopje)
 - Certifikatë që dëshmon për regjistrimin e OJQ-së në Ministrinë e Administratës (kopje)
 - Certifikatë e numrit fiskal (kopje) – të jetë me seli në Klinë, nëndegën në Klinë
 - Konfirmim nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit

Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për projektet

- **Shuma e paraparë për ndarjen e mbështetjes financiare në total është 9.000 €.**

- Formularët për aplikim i gjeni në web-faqen e Komunës së Klinës.
- **Afati i aplikimit është 15 ditë pune nga dita e shpalljes, duke filluar nga data 10.03.2026 deri më 30.03.2026**
- **Aplikacionet e plotësuara duhet të dorëzohen personalisht nga aplikuesi, të jenë të vendosura në zarf dhe të protokolohen në arkivin komunal.**

Vërejtje:

1. **Aplikacionet që dorëzohen pas afatit të paraparë nuk pranohen.**
2. **Të gjithë aplikuesit që nuk e kanë të kompletuar dokumentacionin e kërkuar, nuk do të vlerësohen dhe nuk do të merren parasysh.**

10-451-7049 /26

Klinë, 10.03.2026



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport;